



Datë: 24.04.2025

Numër Protokolli: 2764/2025

A.nr.531/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar Malsore Gashi–Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi-në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 531/2025 të datës 24.03.2025 e parashtruar nga ankuesja F.B kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “Shkelje e të drejtës në pagë”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 24.04.2025, mori këtë;

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr. 531/2025 e datës 24.03.2025 e parashtruar nga ankuesja F.B.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, F.B (tutje referuar vetëm Ankuese), më datë 24.03.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1919/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Zyrtares Publik dhe Ligjit për pagat e Sektorit Publik, jam e diskriminuar me punën që bëje dhe pagën që marr dhe se Ministria e Punëve të Brendshme/Agjencia për Regjistrimin Civil, ka shpallur konkurs dhe ka rekrutuar zyrtar për punë të njëjte me pagë të lartë me koeficient 5.6, ndërsa unë që punoj paguhem me koeficient 4.5, me kualifikim të njëjte (Bachelor),e që është shkelje e rendë ligjore, sepse është dashtë të behët nivelizimi i pagave paraprakisht për zyrtaret që janë në marrëdhënie pune pas hyrjes në fuqi, të këtyre dy ligjeve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.03.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek

Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Këshilli më datën 04.04.2025, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:

Ankesën me numër protokolli 1919/2025 të datës 24.03.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit të datës 31.01.2023, për ankuesen F.B; Kopje e letërnjoftimit për F.B; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 27.03.2025, e dërguar përmes emalit nga R.K, për A.G; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 531/2025, e datës 04.04.2025; Përkshkrimi i Detyrave të Punës; Listat e pagave nga muaji Shkurt deri në muajin dhjetor të vitit 2023, për ankuesen F.B; ; Listat e pagave nga muaji janar deri në muajin dhjetor të vitit 2024, për ankuesen F.B; Lista e pagave për muajin janar dhe shkurt e vitit 2025, për ankuesen F.B;

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesja, konstatoi se ankesa është e parakohshme, sepse:

Nga provat e lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt Emërimit DRSPSH/ARC -11/13, i datës 31.01.2013, është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme/ Agjencia e Regjistrimit Civil, dhe se e njëjta mbanë pozitën e punës “ Nëpunëse Administrative për patentë -shofer”, në QPD Suharekë.

Më datë 24.03.2025 ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Zyrtares Publik dhe Ligjit për pagat e Sektorit Publik, jam e diskriminuar me punën që bëje dhe pagën që marr dhe se Ministria e Punëve të Brendshme/Agjencia për Regjistrimin Civil, ka shpallur konkurs dhe ka rekrutuar zyrtar për punë të njëjte me pagë të lartë me koeficient 5.6, ndërsa unë që punoj paguhem me koeficient 4.5, me kualifikim të njëjte (Bachelor),e që është shkelje e rendë ligjore, sepse është dashtë të behët nivelizimi i pagave paraprakisht për zyrtaret që janë në marrëdhënie pune pas hyrjes në fuqi, të këtyre dy ligjeve.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuses, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: ”1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Ministria e Punëve të Brendshme/ Agjencia e Regjistrimit Civil, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procedimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së sajë të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, (e aplikueshëm deri me datë 21.02.2024), por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë. Andaj, duke qenë se organi përkatës i punësimit nuk ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës sikurse përcaktohej me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Vendimin Nr. 04/128 të datës 16.02.2023 dhe Vendimit Nr.17/162 të datës 27.09.2023, Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku institucionet e administratës publike kanë qenë të obliguara të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës me se voni deri me datë 31.12.2023, Kolegji i Këshillit duke iu referuar dispozitave të nenit 34 të Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, në fuqi nga data 22.02.2024, thekson faktin se institucionet janë të obliguara që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, pra deri me 22.05.2024, andaj, mbi këtë bazë, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankueses, për kategorizimin e pozitës së sajë, është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritior. Rrjedhimisht, e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës se theksuar më lart, ankueses do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tyre të punës.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 531/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, F.B;
- Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së